



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.692/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Habib Makolli nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Drenas, të paraqitur kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të dyshimit se u janë keqpërdorur votat, për Zgjedhjet lokale të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.692/2021 e datës 20.10.2021, e paraqitur nga Habib Makolli kandidat për Kuvend Komunal në Drenas nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, paraqitur kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të dyshimit se u janë keqpërdorur votat në vendvotimin 0322e/02D, për Zgjedhjet Lokale 2021, të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.692/2021 nga Habib Makolli kandidat për Kuvend Komunal në Drenas, nga radhët e Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën theksohet se me datën 17 tetor në dhomën nr. 1 në Çikatov të Vjetër ka pasur 25 vota, ndërsa në dhomën nr2 ku ka votuar vet me familjen Makolli nuk është regjistruar asnjë votë, dhe aty nuk i figuron as vota e tij. Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që të beje rinumërimin e votave për kandidatet për asamble pasi që në këtë vendvotim subjekti politik LVV i ka 48 vota ndërsa parashtruesi i ankese nuk ka asnjë vote.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimin me nr. 0322e/02D në Çikatov të Vjetër në Drenas, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së Habib Makollit nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 692/2021 më datën 20.10.2021



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.